



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 janar 2013
Nr. ref.: RK383/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI97/11

Mon Nushi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Mon Nushi, nga fshati Vraniq, komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson avokati Rexhep Gjicolli nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, i 21 marsit 2011, të cilin, sipas pohimit personal, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 7 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), më 19 korrik 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, të 21 marsit 2011, me anë të të cilit Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesit të kërkesës dhe të vetë parashtruesit të kërkesës, z. Mon Nushi, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 404/2003, të 15 nëntorit 2006.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 dhe neni 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009; dhe rregulli 54, rregulli 55 e rregulli 56.2, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 korrik 2011, Gjykata pranoi nëpërmjet postës kërkesën e parashtruar nga avokati Rexhep Gjokolli, që përfaqëson parashtruesin e kërkesës, z. Mon Nushi nga Gjakova, dhe kjo kërkesë u regjistrua në Gjykatë me Nr. KI97/11.
6. Më 14 nëntor 2011, Gjykata i dërgoi shkresë përfaqësuesit të parashtruesit, me të cilën kërkoi dokumentacion shtesë, të nevojshëm për procedimin e mëtejshëm të kërkesës.
7. Më 22 nëntor 2011, Gjykata, nëpërmjet postës, pranoi dokumentacion shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dhe, me këtë rast, kërkesës i ish-in bashkëngjitur Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, C. nr. 57/83, i 20 majit 1987, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 4040/03, i 15 nëntorit 2006.
8. Më 17 gusht 2012, me vendimin GJR. KI97/11, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues, ndërsa, me vendimin KSH97/11, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gjyljeta Mushkolaj.
9. Më 26 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e vendimit KSH97/11 ashtu që, në pikën 1, për shkak të skadimit të mandatit të saj si gjyqtare, në vend të ish-gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj emëroi në Kolegjin shqyrtues gjyqtarin Kadri Kryeziu.
10. Më 17 janar 2013 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 shtator 1981, sipas pohimeve të përfaqësuesit të kërkesës, z. Mon Nushi, në cilësinë e blerësit, ai kishte lidhur kontratë për shitblerje me z. Mušović Arif nga Gjakova, në cilësinë e shitësit, me objekt kontrate: "Shitblerja e pronës së paluajtshme – shtëpi e oborr, e cila gjendej në Gjakovë, rruga 'Miloš Gilić' nr. 139".

12. Kjo kontratë e pohuar nuk është paraqitur së bashku me kërkesën dhe ekzistencën e saj nuk e kanë vërtetuar as gjykatat e rregullta në procedurat e mëvonshme gjyqësore.
13. Në fakt, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin P. nr. 57/83, kishte konstatuar se një kontratë e tillë e pohuar nga parashtruesi i kërkesës nuk ka vlerë juridike, sepse ishte e lidhur në kundërshtim me dispozitat juridike në fuqi të asaj kohe, por megjithatë, duke vërtetuar faktin se z. Mon Nushi i kishte paguar një shumë të hollash z. Mušović, gjykata e përmendur kishte konstatuar se ai është dëmtuar, andaj, me aktgjykim, urdhëroi zhdëmtimin e tij në shumën prej 1.950.000 dinarësh të atëhershëm, me 7.5% interes, duke filluar nga 18 janari 1983.
14. Më 19 shkurt 2002, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktgjykimin C. nr. 3004/2000, me të cilin refuzoi si të **pabazuar** padinë e paditësit Mon (Nue) Nushi nga fshati Vraniq, komuna e Gjakovës, me të cilën kishte kërkuar nga Gjykata që i padituri Arif (Amri) Mušović TË DETYROHET **të lidhë dhe të vërtetojë** kontratën për shitblerjen e patundshmërisë, me të cilën i padituri i shet paditësit paluajtshmërinë që evidencohet në ngastrën kadastrale nr. 305/4, me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 0,01.15 ha, dhe me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 0.02.14 ha, sipas fletës së posedimit nr. 1133, KK-Gjakovë-qytet.
15. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Komunale në Gjakovë kishte konstatuar se, nga shkresat e lëndës, vërtetohet si i pakontestueshëm fakti që prona e paluajtshme, e cila është objekt kontesti, në dokumentacionin kadastral të Gjakovës evidencohet si pronë e të paditurit Mušović. Gjykata, gjithashtu, kishte konstatuar se asnjëherë nuk ka pasur një kontratë formale, të përpiluar e të vërtetuar në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi, ndërmjet palëve që tash janë në kontest dhe se, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Civ. 57/83, vërtetohet se i padituri, pra z. Mušović, ka qenë i obliguar që paditësit, z. Mon Nushi, t'ia kthejë shumën prej 1.950.000 dinarësh të asaj kohe.
16. Në po të njëjtin aktgjykim, Gjykata Komunale në Gjakovë ka potencuar faktin se paditësi asnjëherë nuk kishte hyrë në posedim të pronës që pretendon se e ka blerë.
17. Kundër këtij aktgjykimi, z. Mon Nushi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, avokatit Teki Bokshi, kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
18. Më 15 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë refuzoi ankesën e paditësit z. Mon Nushi, si ankesë e përfaqësuesit të tij, avokatit Teki Bokshi, duke vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. Nr. 3004/2000, e 19 shkurtit 2002.
19. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjykata e Qarkut theksoi se, duke shqyrtuar ankesat e parashtruara të paditësit dhe të përfaqësuesit të tij, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, “me nxjerrjen e provave të nevojshme, drejt dhe në mënyrë të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe me vlerësimin e drejtë të provave, drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadija është e pabazuar dhe në arsyetim ka dhënë arsye të mjaftueshme juridike dhe faktike për faktet relevante të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë”.
20. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës, z. Mon Nushi, ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
21. Më 21 mars 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 87/2008, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar revizionet e dy përfaqësuesve të autorizuar të z. Mon Nushi, si dhe të vetë paditësit, z. Nushi, të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 404/2003, të 15 nëntorit 2006.

22. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet që “Gjykata Supreme ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar”.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin në fjalë, është shkelur neni 31 i Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe neni 6.1 i KEPDNJ-së, së bashku me protokollet e saj. Parashtruesi më tej thekson se, gjithashtu, janë shkelur edhe nenet: 7, 21, 22, 31, 46, 53 dhe 121 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, që përcakton:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartazi e bazuar”.*

27. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të të drejtave kushtetuese, Gjykata thekson:

28. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, në rastin konkret i Gjykatës Supreme, duke refuzuar revizionin e paditësit dhe të përfaqësuesve të tij dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin Gjykatës së Qarkut në Pejë. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65*).

29. Duke marrë në konsideratë atë që u tha më sipër, Gjykata, sipas rregullit të përgjithshëm, nuk do të kontestojë konstatimet dhe përfundimet që rrjedhin nga instancat e rregullta gjyqësore, si: zbatimin e të drejtës së brendshme, vlerësimin e provave në proces, drejtësinë e rezultatit të një mosmarrëveshje civile apo fajësinë ose jo të një të akuzuari në një çështje penale.

30. Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata mund të vërë në dyshim këto konstatime dhe përfundime, nëse ato janë të njollitura nga një arbitraritet flagrant dhe evident, në kundërshtim me drejtësinë dhe me mirëgjykimin, dhe që shkaktojnë shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së (*Sysoyeva e të tjerë kundër Letonisë (çregjistrim) [DHM], § 89*), e që, gjatë shqyrtimit të kërkesës së z. Nushi, Gjykata nuk ka gjetur elemente të arbitraritetit në vendimet e kontestuara.

31. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrënë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi ECHR, Appl. No. 5503/02, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjykimi i 26 korrikut 2005, ose Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendimi i 9 nëntorit 2006, § 74*).
32. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011, nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të të drejtave të njeriut, sikur kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.
33. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe pika d, gjen se kërkesën duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe pika d, të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani